# Art Park

## Raporti Arkitektonik



Prill 2022

# Art Park

## Raporti Arkitektonik

# 01. ART PARK

## 01. Hyrje

Projekti i Art-Park vendoset në zonen e ish-Kinostudios "Shqipëria e Re", në zonën veri-lindore të kryeqytetit. Shtrirja e projektit perfshin shtepine e pare te filmit shqiptar te ndertuar ne 1952, e cila actualisht sherben si qender e disa institucioneve kryesore te Ministrise se Kultures. Projekti i Art-Park ut synon te revitalizoje atmosferen urbane te te gjithe zones se Kinostudios duke e kthyer ate ne nje nga polet me te rendesishme kulturore te qytetit. Ne perputhje me planin e pergjithshem vendor te Tiranes 2030 I cili parashikon organizimin e qytetit me disa pika graviteti, zona e Kinostudios luan nje rol kyc ne kete organizim si nje nga katalizatoret e saj kulturor.

Ne prizmin e nje katalizatori kulturor, projekti i Art-Parkut perfshin nje sere iniciativash per te rizhvilluar zonen si ne pikepamjen urbane ashtu edhe ne ate social-kulturore.

Art Park nderhyn ne tre pika kryesore:

1. Revitalizimin e parkut perreth Ministrise se Kultures, si dhe zonat perreth saj
2. Aktivizimin e parkut perreth me pavijone kulturore, dhe hapesira per aktivitete ne sherbim te publikut dhe qendres kulturore
3. Rijetezimin e godines fundore te ish-Kinostudios ne nje "Qender te re Kulturore"

Parku perreth Ministrise se Kultures perben nje zone me rendesi nga pikepamja historike dhe aktiviteteve qe jane zhvilluar ne te, si nje nga terrenet kryesore te zhvillimit te filmit per me shume se 5 dekada. Edhe pse jo I aksesueshem per publikun dhe me nje mirembajtje minimale ne vite, ky park ofron nje potencial per t'u shnderruar ne nje destinacion mjaft te rendesishem rekreativ dhe kulturore.

## 01. Revitalizimi i parkut

- shtrimet dhe sistemimi i jashtem i parkut

Sistemimi i jashtem i parkut synon te ruaje sa me shume gjendjen natyrale te tij duke e vene theksin tek karakteri i tij i gjelberimit, pemeve dhe tipareve te ndryshme te vegjetacionit. Ne kete prizem, eshte tentuar te realizohet nje shtrim me sa me pak mineralizim te territorit te gjelberuar duke u kufizuar tek shtrimet minimale te cilat ofrojne mundesi kalimi per kembesorine nga njera pike e parkut ne tjetrin, si dhe aksesin e bicikletave te cilat jane trajuar ne te njejtin nivel me kembesorine dhe dizajni e parkut eshte organizuar ne menyre te tille per te qene sa me ftues per keto loje perdoruesish.

Materialet e perdorura per shtrimin jane te tre tipologjive:




- rrugicat me zhavorr dhe cimento

- rrugicat dhe sheshet me beton te lare

- rrugicat me gur natyral

stone path / rrugica me gurë

paving with gravel and cement / shtrim me zhavorr me çimento

washed concrete / shtrime me beton të larë

- Gjelberimi i Parkut

Ai eshte i sistemuar me gjelberim te dendur sidomos ne zonen lindore te qytetit qe sheh nga Dajti dhe pershkruhet nga nje ullishte e dendur ne nje gjendje relativisht te mire. Ne brendesi te tij gjenden jo vetem peme ulliri te shendetshem por edhe peme te llojeve





foto nga parku ekzistues ne zonen e ullishtes



Ne brendesi te tij gjenden jo vetem peme ulliri te shendetshem por edhe peme te llojeve te tjera, te vendosur kryesisht ne zonen e prapme te objektit te Ministrise se Kultures. Synimi I projektit ne kuader te revitalizimit te parkut eshte te ruaje sa me shume pemet ekzistuese dhe ta pasuroje me shume ate.

Perpos pemeve te reja dhe barit I cili eshte I pranishem ne kete park, karakteri I



foto nga parku ekzistues kujdrejt Ministrise se Kultures



Sideritis Syriaca



Coriandrum sativum

gjelberimit ne zonen e Kinostudios nuk do te kufizohet vetem tek shtimi I pemeve te reja, por edhe pasurimi I tij ne disa nivele hierarkie, duke vijuar me shkurret e medha, shkurret e vogla, bime shumevjecare si dhe lendine.

Vecanerisht llojet e bimeve te perzgjedhura per te kultuvuar kopshtin e Kinostudios, synojne te behen jo vetem pjese e kopshtit nga pikepamja estetike dhe aromatike, por jane perzgjedhur ne menyre te tille qe mund te bashkejetojne mire me banoret perreth si dhe nga perdoruesit e godinave ne afersi.

- Mobilimi Urban

Per te aktivizuar parkut, i gjithe parku eshte mobiluar me stola urbane te llojeve te ndryshme, qe pershkruan kryesisht rrugicat qe gjarperojne neper park. Stolat jane te



reference per stolat e perbashket

larmishem duke filluar qe nga stolat individuale deri tek stolat e perbashket. Njekohesisht do te kemi ne park edhe karrige te levizshme te cilat mund te perdoren jo vetem per te akomoduar nje numer te konsiderueshem njerezish ne pavijonet e ndryshme te shperndara neper park por edhe perdorime ne grup ne vete zonen e gjelberuar.

- Instalacionet Artistike

Perpos grumbullimeve dhe perdorimin e vete parkut si nje terren per aktivitete, ne pika te vecanta te parkut do te mund te vendosen instalacione te ndryshme artistike, si ato me karakter ndricues, te artit pamor apo zanor. Projekti I parkut parashikon infrastrukturen per ta mundesuar ate, ne menyre qe perdoruesit e ndryshem, vecanerisht ato te Qendres Kulturore te mund te ekspozojne punimet e tyre per te gjithe publikun.



reference per atmosferen e kopshtit ne brendesi te parkut






pavijone per panelet e cmontueshme

Ekspozimi I punimeve artistike eshte I mundur te realizohet jo vetem nepermjet instalacioneve. Parku, ne brendesi te tij eshte konceptuar si nje lendine e hapur per te lejuar realizimin e momenteve te ndryshme qe vijne ne forme 'suprize' duke qene te vendosura me ne brendesi te parkut dhe jo lehtesisht te dukshme nga jashte.

Me ane te paneleve te cmontueshme, te cilat mund te vendoset sipas nevojave te artistit, parku kthehet keshtu ne nje terren te plote ekspozimi ku ne cdo moment mund te kete 'surpriza' nga vete artistet me punimet e tyre. Per sistemimin dhe ruajtjen e ketyre paneleve te cmontueshme dhe te levizshme jane menduar kabina te vogla druri, te cilat nuk ngarkojne parkun, por plusojne neper te ne nivel pikesor, hera herez edhe te kamufluara brenda gjelberimit te tij.

Gent Agolli Digitally signed by Gent Agolli Date: 2022.04.13 10:36:28 +02'00'
Benida Kraja Digitally signed by Benida Kraja Date: 2022.05.23 11:08:03 +02'00'
Klodjana Gjata Digitally signed by Klodjana Gjata Date: 2022.05.23 12:46:05 +02'00'
Rudina Papavasi Digitally signed by Rudina Papavasili Date: 2022.05.23 01:14:58 +02'00'
Rudina Zoto Digitally signed by Rudina Zoto Date: 2022.05.23 01:19:49 +02'00'